



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 509, datë 05.10.2023

PËR

PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR TË ZNJ. {...}, PËR POZICIONIN E NDIHMËSIT LIGJOR NË NJËSINË E SHËRBIMIT LIGJOR PRANË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË APELIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “d” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 61, 90, pika 1, shkronja “c” dhe “h” dhe 97, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 42, pika 1, 36 dhe 59 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, si dhe në vendimin nr. 498, datë 28.09.2023, “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}”, pasi shqyrtoi relacionin dhe materialet përkatëse, mbi propozimin e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VEREN:

I. MBI FAKTET E PROCESIT PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR TË ZNJ. {...}

1. Me vendimin nr. 125, datë 04.04.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “Këshilli”) konstatoi se znj. {...} plotësonte kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës (në vijim “SHM”), për vitin akademik 2022-2023, profili “Ndhmës ligjor”. Ky verifikim u krye bazuar në nenet 34 pika 6, 53 pika 4, 55 dhe 56, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (në vijim si “Ligji për Pushtetin Gjyqësor”).
2. Me vendimin nr. 213, datë 16.06.2022, mbështetur në nenin 53, të ligjit “Për Pushtetin Gjyqësor”, si dhe në Vendimin nr. 424/2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, Këshilli, ka filluar procedurën e verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, viti akademik 2022 - 2023, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat.

3. Në përfundim të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për pozicionin e ndihmësit ligjor, Këshilli me vendimin nr. 543, datë 14.12.2022 ka vendosur kualifikimin e kandidatës fituese znj. {...} dhe lejimin e saj për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2022 – 2023, profili “Ndhmës ligjor”.
4. Znj. {...} ka ndjekur programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor viti akademik 2022-2023 në Shkollën e Magjistraturës. Me Vendimin nr. 30, datë 18.07.2023, “Për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për ndihmës ligjor në Programin e Formimit Fillestar”, Shkolla e Magjistraturës e rendit të parën në listën e kandidatëve, me 78.6 % të pikëve (më shumë se 70% të pikëve në total).
5. Këshilli me vendimin nr. 498, datë 28.09.2023, ka miratuar kualifikimin dhe vijimin e procedurës së emërimit përfundimtar në shërbimin civil gjyqësor në pozicionin e ndihmës ligjore në gjykatat e apelit, të znj. {...}.

II. VLERËSIME TË KËSHILLIT MBI PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR TË ZNJ. {...}

6. Këshilli vlerëson se një ndër përgjegjësitë e tij të ngarkuara nga Kushtetuta e Republikës është dhe ajo lidhur me drejtimin dhe kujdesjen e mbarëvajtjes së punës në administratën e gjykatave, bazuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja “d”, dhe “ë”, ku theksohet se (citojmë): “1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: ... **d**) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me përjashtim të mbarëvajtjes së strukturave të teknologjisë së informacionit në gjykata, e cila rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave; **ë**) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.”
7. Në Ligjin për Pushtetit Gjyqësor, i ndryshuar, që në nenin 1, pika 1, shkronja “d”¹ është parashikuar se një ndër qëllimet e tij kryesore është edhe përcaktimi i rregullave lidhur me statusin e nëpunësve civilë gjyqësor. Edhe në nenin 50 e në vijim, deri në nenin 63, të këtij ligji i dedikohet pikërisht statusit të nëpunësve civilë gjyqësor në gjykatë. Në këto dispozita², lidhur me organin kompetent për pranimin në shërbimin civil gjyqësor, për kategoritë kancelar, këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe ndihmës ligjor në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit është ngarkuar të jetë Këshilli i Lartë Gjyqësor. Kjo kompetencë është e sanksionuar në nenin 59 të këtij ligji ku theksohet se “1. Organi kompetent për emërimin e kancelarit, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor është Këshilli i Lartë Gjyqësor.”.
8. Lidhur me kriteret e përgjithshme që duhet të plotësohen për ndihmës ligjor, ligji parashikon si të tilla, të njëjtat kriteret të përgjithshme që duhet për pranimin në shërbimin civil, të parashikuar në legjislacionin për nëpunësin civil, ndërkohë që si kriteret të veçanta për këtë kategori, kategorinë e ndihmësit ligjor në gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit, ligji i parashikuar në pikën 2 të nenit 56 të Ligjit Për Pushtetin Gjyqësor, i ndryshuar dhe që janë (citojmë): “2. Për pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e

¹ Neni 1, pika 1, shkronja “d” e ligjit nr.98/2016 parashikon se: “1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i parimeve të përgjithshme dhe i rregullave në lidhje me: ... d) statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë.”

² Neni 50 I ligjit nr.98/2016, i ndryshuar parashikon se: 1. Kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë janë: a) kancelari; b) këshilltari ligjor në Gjykatën e Lartë; c) ndihmësi ligjor në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit; ç) kryesekretari; d) sekretari gjyqësor; dh) nëpunësi i financës dhe buxhetit; e) nëpunës të tjerë që punojnë në fushat e kërkimit ligjor dhe dokumentacionit, burimeve njerëzore, teknologjisë së informacionit, arkivit dhe marrëdhëniet me publikun, me jashtë ose me median. 2. Statusi i nëpunësve civilë gjyqësorë rregullohet nga ky ligj.

shkallës së parë dhe apelit, kandidatët duhet të përmbushin këto kritere të veçanta: a) të jenë diplomuar në drejtësi në nivelin “Master shkencor”, të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë; b) të kenë përvojë profesionale jo më pak se tre vjet, si nëpunës në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barazvlefshtëm me to, në sektorin privat ose në organizatat ndërkombëtare”.

9. Bazuar në këto kritere të mësipërme, Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimin të Kritereve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhimës Ligjorë pranë Këshillit dhe më pas vetë Këshilli me vendimin nr. 125, datë 04.04.2022, ka konstatuar faktin se znj. {...} plotëson kriteret e përcaktuara nga ligji për të ndjekur Programin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2022–2023, profili “Ndhimës ligjor”.
10. Në përfundim të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për pozicionin e ndihmësit ligjor, Këshilli me vendimin nr. 543, datë 14.12.2022 ka vendosur kualifikimin e kandidates fituese znj. {...} dhe lejimin e saj për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2022 – 2023, profili ndihmës ligjor. Gjithashtu konstatohet se në përfundim të Shkollës së Magjistraturës me Vendimin nr. 30, datë 18.07.2022, “Për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për ndihmës ligjor për vitin akademik 2022 – 2023”, SHM e ka renditur znj. {...} në listën e kandidatëve fitues, klasifikuar e para dhe ka marrë 77.17 pikë, ose 78.6 % (më shumë se 70% të pikëve totale).
11. Rezulton gjithashtu se Këshilli me vendimin nr. 498, datë 28.09.2023, ka miratuar kualifikimin dhe vijimin e procedurës së emërimit përfundimtar në shërbimin civil gjyqësor në pozicionin e ndihmës ligjore në gjykatat e apelit, të znj. {...}, në këtë mënyrë është plotësuar edhe një tjetër kriter i përcaktuar nga ligji dhe të cilin duhet të plotësojnë kandidatët për t’u pranuar në shërbimin civil gjyqësor, kategoria “Ndhimës ligjor”.
12. Kandidatët, për zbatim të nenit 64, pika 7, ligji nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar “7. Kancelarët, këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë kandidatë detyrohen të kthejnë të gjithë shpërblimin e marrë brenda tre vjetëve në rast se kandidati përjashtohet ose largohet nga shkolla ose në rast se kandidati nuk kërkon të caktohet në një pozicion brenda një viti nga përfundimi i arsimimit në Shkollën e Magjistraturës”, kanë depozituar, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, kërkesat për emërim dhe trajtim financiar.
13. Nga ana e Këshillit konstatohet se znj. {...} ka paraqitur kërkesën e regjistruar me aktin nr. 5025 prot., datë 29.09.2023, në të cilën shprehet interesi për emërim si ndihmës ligjor pranë Njësisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, duke theksuar faktin se ajo ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë ambientale në lidhje me pozicionin vakant pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, pasi bashkëjetuesi i saj ushtron detyrën si gjyqtar pranë kësaj gjykate.
14. Për shkak se znj. {...}, ka shprehur interesin për emërimin në pozicionin e Ndhimësit ligjor pranë Njësisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, ka plotësuar të gjitha kriteret dhe kushtet e parashikuara nga ligji për këtë pozicion, Këshilli ka detyrimin të bëjë emërimin e saj në pozicion, në rastin e pasjes së vendit të lirë për këtë kategori nëpunësish civil gjyqësor. Ndaj për këtë qëllim është e nevojshme të shihet organika e Gjykatës Administrative të Apelit lidhur me organizimin dhe numrin e

ndihmësive ligjorë. Neni 42 i Ligjit për Pushtetin Gjyqësor parashikon, organizimin dhe funksionimin e Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë gjykatave të shkallës së parë dhe apelit, njësi e cila përbëhet nga ndihmës ligjorë, e krijuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor (konkretisht vendimi nr. 495, datë 21.10.2020, “Për krijimin e njësive të shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit”).

15. Nga dokumentacioni që disponohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, pranë KLGJ-së konstatohet se në organikën e Gjykatës Administrative të Apelit lidhur me pozicionin “ndihmës ligjor” ka në përbërje 13 të tillë, nga të cilët në detyrë, në momentin e marrjes së këtij vendimi janë 7 ndihmës ligjor. Pra konstatohet se ka një numër të konsiderueshëm pozicionesh të lira në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit.
16. Lidhur me emërimin e ndihmësit ligjor, neni 59, pika 3 e ligjit për pushtetit gjyqësor, parashikon se ajo kalon nëpërmjet një procedure *zgjedhje* nga Këshilli të kandidatëve të cilët paraqesin kërkesë. Në një rast të tillë Këshilli do të duhet të mbajë në konsideratë, **a) renditjen në listën e kandidatëve; b) çdo njohuri ose përvojë të veçantë të kandidatit, që e bën atë veçanërisht të kualifikuar për vendin e lirë; c) vitet e përgjithshme të përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose në pozicione drejtuese.** Kjo procedurë e parashikuar nga ligji mban në konsideratë rastin kur kemi më shumë kandidatë sesa vende vakant të lirë, ndërkohë në rastin konkret, të emërimit të znj. {...}, për sa kohë që në njësinë e shërbimit ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit ka shumë pozicione të lira procedura e *zgjedhjes* e parashikuar nga pika 3 e nenit 59, të ligjit të sipërcituar nuk ka vend për t’u zbatuar.
17. Në realizimin e kësaj procedure, Këshilli gjithashtu mban në konsideratë se vende të lira në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit ka për më shumë se 5 të tillë.

III. KONKLUZIONI

18. Në gjithë sa më sipër, duke konstatuar se znj. {...}, plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit për nëpunësit civil gjyqësor në kategorinë “*Ndihmës ligjor*”, në kushtet kur ajo ka përfunduar me sukses Shkollën e Magjistraturës dhe është kualifikuar në procesin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës, si dhe kur pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit ka 6 (gjashtë) pozicione të lira për ndihmës ligjor, Këshilli vlerëson t’a pranojë në shërbimin civil gjyqësor, për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit.
19. Për shkak të kushteve dhe nevojave që ka Gjykata Administrative e Apelit ku kontributi i ndihmësive ligjorë konsiderohet i rëndësishëm vlerësohet që ushtrimi i veprimtarisë së znj. {...} në këtë gjykatë të fillojë më datë 06.10.2023.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “d” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 61, 90, pika 1, shkronja “c” dhe “h” dhe 97, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 42, pika 1, 36 dhe 59 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin nr. 424, datë 12.10.2020, “Për

procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, si dhe në vendimin nr. 498, datë 28.09.2023, “Për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}”, pasi shqyrtoi relacionin dhe materialet përkatëse, mbi propozimin e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit.
2. Efektet juridike të këtij vendimi, përfshirë dhe ato financiare, fillojnë më datë 06.10.2023.
3. Një kopje e vendimit të arsyetuar i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës Administrative të Apelit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR